REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT VENDIM

Nr.___, datë 28.08.2025

"PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)"

Në mbështetje të nenit 2, pika11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.6, shkronja "b", nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja "d" dhe "gj", nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja "h", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore", Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 "Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve te qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Bashkisë Poliçan në SKP, të quajtur "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)", bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi".

5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Poliçan të përfaqësojë Bashkinë Poliçan në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Poliçan nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA.

6. Ngarkohet Kryetari Bashkisë, Drejtoria e Financave dhe Buxhetit të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

KRYETARI I BASHKISE	JURISTE	SEKRETARE KESHILLIT
ADRIATIK ZOTKAJ	DESANTILA ZAIMI	LINDITA KONDI